

SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI FOTOSENSITIVE

- Krizantema
- Dong Quai (Angelica sinensis)
- Kërpuđha Shiitake
- Lulja e basanit

NDËRVEPRIME TË MUNDSHME

Rrit ndjeshmërinë e lëkurës ndaj rrezeve të diellit.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që po trajtohen me terapi me rrezatim

SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI NDRYSHUESE TË IMUNITETIT

- Astragalus
- Kërpuđha Maitake dhe Reishi
- Rudbekia
- Veshtulla (evropiane)

NDËRVEPRIME TË MUNDSHME

Mund të nxisin ose frenojnë sistemin imunitar.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që marrin barna frenuese të imunitetit
- Pacientët me limfomë

SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI ESTROGJENIKE

- Kohoshi i zi
- Kaçubja e murgut
- Dong Quai (Angelica sinensis)
- Produktet e sojës
- Xhinko biloba
- Tërfile i kuq
- Vaji i farës së lirit

NDËRVEPRIME TË MUNDSHME

Efektet estrogjenike mund të stimulojnë rritjen e tumorit të varur nga estrogjeni.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që vuajnë nga kanceri i gjirit (veçanërisht ata me kancer pozitiv ndaj receptorëve hormonalë)
- Pacientët me kancer endometrial

E drejta e autorit 2017 Michigan Oncology Quality Consortium (MOQC). Të gjitha të drejtat e rezervuara. MOQC nuk jep asnjë deklaratë ose garanci dhe mohon shprehimisht përshtatshmërinë ose zbatueshmërinë e përmbajtjes së MOQC për kujdesin ose trajtimin specifik të ndonjë pacienti. Çdo klinikist që kërkon të trajtojë një pacient duke përdorur përmbajtjen e MOQC pritët që të përdorë gjykim të pavarur mjekësor në kontekstin e rrethanave klinike individuale të kujdesit ose trajtimit të pacientit specifik.

Weiger WA, et al. Ann Intern Med. 2002;137(11):889-903. Ngo terapi Z. CAM. CancerSupportveCare.com 2004;

Arslan D, et al. J Palliat Med. 2013;16(11):1466-1476. Frenkel M, et al. Integr Cancer Ther. 2013;12(5):369-384. Ngo terapi Z. CAM. CancerSupportveCare.com 2004. Weiger WA, et al. Ann Intern Med. 2002;137(11):889-903.

SUPLEMENTET BIMORE dhe TRAJTIMI I KANCERIT





SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI ANTIOKSIDUESE

- Hudhra
- Xhinko biloba
- Xhenseni
- Ekstrakti i farës së rrushit
- Çaji jeshil
- Vitaminat E dhe C në dozë të lartë
- Melatonina
- Tërfilli i kuq dhe CoQ10
- Seleni

NDËRVEPRIME TË MUNDSSHME

Mund të ndërhyjnë në efektet vrasëse të kancerit të kimioterapive dhe rrezatimeve të caktuara.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që po trajtohen me terapi me rrezatim
- Pacientët që janë duke u trajtuar me kimioterapi të caktuara

SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI MODIFIKUESE TË ENZIMAVE

- Kohoshi i zi
- Kurkuma (shafrani i indisë)
- Rudbekia
- Çaji "Essiac"
- Hudhra
- Xhenseni
- Bima e rrënjës së artë
- Ekstrakti i farës së rrushit
- Kava
- Jamballi
- Gjemb i gomarit
- Veshtulla (evropiane)
- Hithra
- Kërpuq Reishi
- Ekstrakti i sojës
- Lulja e basanit
- Valeriana

NDËRVEPRIME TË MUNDSSHME

Mund të ndikojnë në mënyrën e shpërbërjes së barit të kimioterapisë në trup dhe mund të rrisin ose të ulin funksionimin e tij.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që marrin barna të caktuara të kimioterapisë orale

SUPLEMENTE TË ZAKONSHME BIMORE ME VETI HOLLUESE TË GJAKUT

- Kurkuma (shafrani i Indisë)
- Dong Quai (Angelica sinensis)
- Aguliçja e mbrëmjes
- Kamomili i egër
- Vaji i peshkut
- Hudhra
- Xhinko biloba
- Xhenseni
- Ekstrakti i farës së rrushit
- Vitaminat E dhe C në dozë të lartë
- Kërpuq Maitake dhe Reishi
- Seleni

NDËRVEPRIME TË MUNDSSHME

Mund të frenojnë aftësinë e pllakëzave të gjakut për t'u grumbulluar së bashku (për të formuar tromb) dhe të rrisin rrezikun për gjakderdhje.

KUSH DUHET TA SHMANGË PËRDORIMIN E TYRE

- Pacientët që i nënshtrohen një ndërhyrjeje kirurgjikale
- Pacientët me numër të ulët pllakëzash gjaku
- Pacientët që marrin hollues gjaku